



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2019:282614
Datë: 10.01.2025
Numri i dokumentit: 06696222

P.nr.185/2005

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – Departamenti për Krime të Rënda (në objektin e Gjykatës në Mitrovicë - Veri), Kryetari i Trupit Gjykues Avni Mehmeti, me zyrtaren Ligjore Edita Kelmendi-Rexhepi, në çështjen penale kundër të pandehurit Z.G nga Z.P, i akuzuar për veprën penale: Rrezikimi i personelit të Kombeve të Bashkuara dhe i personelit në marrëdhënieve me to sipas nenit 142 par.3 e lidhur me nën paragrafin 3 të Kodit Penal të Kosovës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Publike të Qarkut në Mitrovicë, PP.nr...../2005 të datës 19.04.2005. Në mbështetje të nenit 357 par.1 nën paragrafi 1.3 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (më tej i referohemi me shkurtesën KPP), sipas detyrës zyrtare dhe jashtë seancës me datën 10.01.2025, nxjerr ketë:

A K T V E N D I M

- I.** HEDHET - Akuza e Prokurorisë Publike të Qarkut në Mitrovicë, PP.nr...../2005 e datës 19.04.2005 dhe PUSHOHET procedura penale kundër të pandehurit;
- Z.G nga i ati, e ëma, e vajzërisë, i lindur më datën në M....., me vendbanim në Rr “” pn në Z.P, për veprën penale rrezikimi i personelit të Kombeve të Bashkuara dhe i personelit në marrëdhënieve me to, sipas nenit 142 par.3 e lidhur me nën paragrafin 3 të Kodit Penal të Kosovës.
- II.** I pandehuri Z.G lirohet nga pagesa e shpenzimeve të procedurës penale dhe shpenzimet e shkaktuara mbulohen nga mjetet buxhetore të kësaj gjykate.
- III.** Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesë pasurore udhëzohet në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Publike e Qarkut në Mitrovicë, ka ngritur akuzën PP.nr...../2005 me datën 19.04.2005, kundër të pandehurit Z.G, për veprën penale rrezikimi i personelit të Kombeve të Bashkuara dhe i personelit në marrëdhënieve me to sipas nenit 142 par.3 e lidhur me nën paragrafin 3 të Kodit Penal të Kosovës, dhe për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo në shfrytëzim të paautorizuar të armëve sipas nenit 328 paragrafi 2 të KPK-së.

Gjykata Themelore në Mitrovicë, sipas aktvendimit P.nr.185/2005, të datës 11.04.2014, e ka hedhe pikën II të aktakuzës dhe e ka pushuar procedurën penale ndaj të pandehurit për veprën penale, mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo në shfrytëzim të paautorizuar të armeve, sipas nenit 328 paragrafi 2 të KPK-së.

Në këtë rast, siç është theksuar edhe më lart i pandehuri Z.G, akuzohet për veprën penale, rrezikimi i personelit të Kombeve të Bashkuara dhe i personelit në marrëdhënieve me to sipas nenit 142 par.3 e lidhur me nën paragrafin 3 të Kodit Penal të Kosovës, për të cilin parashihet dënimi deri në dhjetë vjet burgim.

Me qëllim të sigurimit të prezencës së të pandehurit në procedurën penale, më datën 18.03.2018, kjo Gjykatë ka urdhëruar arrestimin e të pandehurit Z.G, pastaj, më datën 12.12.2018 ka urdhëruar Letërrreshtimi vendor. Ndërsa, më datën 12.07.2023, ka parashtruar kërkesën për lëshimin e Letërrreshtimi Ndërkombëtar, përmes Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Kosovës. Përkundër të gjitha masave që janë ndërmarr nuk është arritur që të sigurohet prezenca e të pandehurit në gjykim si rrjedhojë çështje penale kundër tij nuk është përfunduar deri tani.

Gjykata rikujton se në bazë të nenit 90 par.1 nënpar.1.3 të KPK-së, përcaktohet se ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar 10 (dhjetë) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se pesë vjet burgime deri në dhjetë vjet. Ndërkaq, sipas nenit neni 91 par.1 të KPK-ës, përcaktohet se afati i parashkrimit të ndjekjes penale fillon të rrjedh nga dita kur është kryer vepra penale, ndërsa sipas paragrafi 6 po të njëjtit nen përcaktohet se ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit (ndalesa absolute mbi ndjekjes penale).

Duke u bazuar në faktet e çështjes penale, rrjedh se më datën 03.01.2005, dyshohet se është kryer vepra penale, rrezikimi i personelit të Kombeve të Bashkuara dhe i personelit në marrëdhënieve

me to sipas nenit 142 par.3 e lidhur me nën paragrafin 3 të Kodit Penal të Kosovës, ndërsa nga kjo kohë e deri më tani kanë kaluar më tepër se (20) njëzet vjet, pra, ka kaluar dyfishi i kohës së parashkrimit relativ dhe sipas nenit 91 par.6 të KPK-së, prandaj në këtë rast penal ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale. Parashkrimi absolut ka arritur më 03.01.2025, sepse ka kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit të përcaktuar me nenin 90 par.1 nënpar.1.3 të KPK-së.

Gjykata edhe njëherë konstaton se në rastin konkret ndaj të pandehurit Z.G janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme ligjore, lidhur sigurimin e prezencës së të pandehurit në procedurën penale por që prezenca e tij nuk është arrit që të sigurohet.

Gjykata rikujton se mbështetur në nenin 357 par.1.nënparr 1.3 të KPP-ës, Gjyqtari i vetëm gjykues ose Kryetari i trupit gjykues ka për obligim që të hedh aktakuzën dhe ta pushoj procedurën penale në rastet kur konstaton se ka arritur parashkrim i ndjekjes penale.

Gjykata duke vlerësuar këtë fakt konstaton se parashkrimi i ndjekjes penale është një fakt dhe rrethanë që në çdo rast sapo të vërtetohet se ekziston, rrjedh obligimi që sipas ligjit të hedhet akuza dhe pushohet procedurën penale. Ashtu që kjo Gjykatë, pasi ka vërtetuar se ka arrit parashkrimi absolut për veprën penale rrezikimi i personelit të Kombeve të Bashkuara dhe i personelit në marrëdhënieve me to sipas nenit 142 par.3 e lidhur me nën paragrafin 3 të Kodit Penal të Kosovës, e ka hedh akuzën dhe e ka pushuar procedurën penale ndaj të pandehurit Z.G.

Për sa i përket shpenzimeve të procedurës penale, Gjykata ka vendosur për këto shpenzime në bazë të nenit 454 të KPP-së, ku është përcaktuar se kur pushohet procedura penale shpenzimet e procedurës paguhen nga mjetet buxhetore, për këtë arsye edhe ka vendosur si në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të dispozitave të nenit 90 par 1 nënpar.1.3 dhe nenit 91 par.1 dhe 6 të KPK-së, e në mbështetje të nenit 357 par.1 nën paragrafi 1.3 të KPP-ës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Numri i lëndës: 2019:282614
Datë: 10.01.2025
Numri i dokumentit:06696222

GJYKATA E THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti për Krime të Rënda

P.nr.185/2005 dt.10.01.2025

Kryetari i Trupit Gjykes-gjyqtari:

Avni Mehmeti

KËSHILLË JURIDIKE: kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejt ankese në afat prej 3 ditësh, nga momenti i pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit ne Prishtinë nëpërmjet kësaj Gjykate.